

Numri:

Vendosi: Paneli i Gjykatës Kushtetuese

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Z. Driton Lajçi

Data: 13 nëntor 2019

Gjuha: Anglishte

Emri i dosjes:

Klasifikimi: Publik

**Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me
Ligjshmërinë e Procedurës së Marrjes në Pyetje**

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Z. Xhek Smith

Mbrojtësi i Specializuar për

z. Driton Lajçi

Z. Tobi Kadman

1. Hyrje

- 1.1. Kjo kërkesë referuese parashtrohet prej z. Driton Lajçi (më tej: Parashtruesi) në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta).
- 1.2. Objekti i ankesës është a ishte i ligjshëm dhe/ose në pajtim me Kushtetutën urdhri i Zyrës së Prokurorit të Specializuar (më tej: ZPS), ku parashtruesi urdhërohej që të paraqitej për marrje në pyetje, duke marrë parasysh se në fletëthirrjen e lëshuar:
 - a) nuk bëhej e njohur vepra penale konkrete për kryerjen e së cilës dyshohej parashtruesi; dhe
 - b) nuk bëhej e ditur se në çfarë provash bazohej dyshimi për kryerjen e veprës penale prej parashtruesit.
- 1.3. Gjithashtu, parashtruesi ngre pyetjen nëse “procedura e intervistës” që përmendet në kuadrin e kësaj ankese ishte e ligjshme dhe/ose në pajtim me Kushtetutën, për arsye se:
 - a) As parashtruesi, as mbrojtësi i tij ligjor, z. Tobi Kadman, nuk u informuan para nisjes së intervistës në lidhje me veprën penale konkrete për kryerjen e së cilës dyshohej parashtruesi;
 - b) As parashtruesit, as mbrojtësit të tij ligjor, z. Tobi Kadman, nuk iu bë e ditur para intervistës se në çfarë provash bazohej dyshimi se parashtruesi kishte kryer vepër penale.

- 1.4. Fillimisht parashtrohet me respekt se fletëthirrja dhe më pas procedura e përcaktuar për intervistën në bazë të kësaj fletëthirrjeje, nuk janë në pajtim me:
- a) Kushtetutën e Kosovës;
 - b) Rregulloren e Procedurës dhe të Provave për Dhomat e Specializuara të Kosovës; dhe
 - c) obligimet e Kosovës dhe rrjedhimisht të Dhomës për të vepruar në pajtim me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ku përfshihen:
 - i. Marrëveshja Ndërkombëtare për Të Drejtat Civile dhe Politike (MNDCP); dhe
 - ii. Konventa Evropiane për Të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

2. Kronologji e fakteve

- 2.1. Fillimisht parashtruesi u thirr për intervistë më 29-30 maj 2019, mirëpo ZPS-ja e anuloi intervistën për arsye operative.
- 2.2. Më 25 shtator 2019, parashtruesi mori një fletëthirrje nga ZPS-ja ku i kërkohej të paraqitej për marrje në pyetje, në Hagë, më 17-18 tetor 2019, në orën 09:00. Nuk bëhej e ditur nëse kohëzgjatja e intervistës do të ishte dyditore ose nëse ajo do të mbahej brenda kalendarit dyditor.
- 2.3. Në fletëthirrje shkruhet se ajo *“ka lidhje me hetime penale zyrtare prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar”*, dhe se *“duke qenë se ka arsye të besohet se ju mund të jeni përfshirë në kryerjen e një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara të Kosovës ...”*.

- 2.4. Fletëthirrja nuk paraqet informacion të mëtëjshëm në lidhje me veprën penale për kryerjen e së cilës dyshohet parashtruesi.
- 2.5. Më 13 tetor 2019, ZPS-së iu dërgua letër ku pyetej për *'bazën dhe arsyet e pretendimeve, gjegjësisht cilat janë pretendimet konkrete'*. Këtij peticioni i bashkëngjitet kopja e korrespondencës.
- 2.6. Në letër më tej theksohej *"Fletëthirrja nuk është e detajuar në mënyrë të mjaftueshme dhe nuk bën të ditur ndonjë vepër penale në shkelje të standardeve të pranuar ndërkombëtare për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale"* dhe se *"nuk është bërë i ditur asnjë material që mund të përbëjë bazën dhe arsyet e ndonjë pretendimi"*.
- 2.7. Në letër kërkohet që para intervistës, *"vepra penale të detajohet ashtu siç duhet për të siguruar që z. Lajçi të ketë dijeni se për çfarë i kërkohet të japë përgjigje, si edhe që t'i jepen me shkrim baza dhe arsyet e pretendimit së bashku me materialet përkatëse"*.
- 2.8. Më 14 tetor 2019, ZPS-ja ktheu përgjigje përmes postës elektronike ku informonte se *"...Ligji nuk kërkon që ZPS-ja t'i japë klientit tuaj detaje të provave që posedon në këtë moment"*.
- 2.9. Sidoqoftë në mesazhin elektronik më tej lexohet se *"Zyra e Prokurorit të Specializuar po heton rolin e zyrës së klientit tuaj dhe të klientit tuaj si individ në lidhje me pengim të mundshëm të drejtësisë, duke përfshirë pa kufizime shkelje të mundshme të nenit 394 (pengimi i të provuarit ose procedurës zyrtare) dhe nenit 395 (frikësimi gjatë procedurës penale) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i përfshirë në nenin 15(2) të Ligjit."*
- 2.10. Rrjedhimisht, ZPS-ja nuk pranon të bëjë të njohur asnjë provë në lidhje me pretendimin, prova që do të ndihmonin mbrojtësin e autorizuar që t'i ofronte këshilla të përshtatshme parashtruesit.

- 2.11. Gjithsesi, është me vend të theksohet se, duke u bazuar në faktin se në mesazhin elektronik të 14 tetorit 2019 ZPS-ja konfirmoi veprat penale në lidhje me të cilat do të pyetej parashtruesi, mund të deduktohet se ZPS-ja pranon se fletëthirrja nuk ishte e detajuar në mënyrë të mjaftueshme.
- 2.12. Në mbrëmjen e 16 tetorit 2019, një prokuror i ZPS-së kontaktoi përmes telefonit mbrojtësin e parashtruesit, z. Artan Qerkini, dhe pyeti nëse parashtruesi kishte ndër mend t'u përgjigjej me "no comment" pyetjeve gjatë intervistës. Prokurori u informua se, duke u bazuar në faktin se para intervistës ZPS-ja nuk kishte dhënë informacion mbi bazën dhe arsyet e pretendimeve së bashku me materialet përkatëse, parashtruesi nuk do t'i përgjigjej asnjë pyetjeje.
- 2.13. Më 17 tetor 2019. parashtruesi u paraqit për intervistë së bashku me mbrojtësin e tij të autorizuar. Intervista u mbajt midis orës 09.51 – 10.30 dhe 10.35 – 10.54.
- 2.14. Para intervistës nuk u bë i njohur asnjë material përpos veprës penale të përmendur në paragrafët 2.9 dhe 2.11 më lart.
- 2.15. Z. Kadman, në cilësinë e mbrojtësit të autorizuar, nuk ishte në gjendje t'i ofronte këshilla parashtruesit për shkak të refuzimit për të dhënë detaje dhe rrjedhimisht parashtruesi ushtroi të drejtën për të mbajtur heshtje dhe vetëm konfirmoi se ai nuk do të bënte koment për asnjë nga pyetjet që do t'i bëheshin, pikërisht për shkak të këtij refuzimi.
- 2.16. Parashtruesi paraqiti një deklaratë me shkrim, që i bashkëngjitet këtij peticioni, e cila u lexua me zë për hir të procedurës zyrtare.
- 2.17. Gjatë intervistës, Prokurori deklaroi për hir të procedurës se ZPS-ja nuk kishte refuzuar ta përmbushte kërkesën dhe parashtroi arsyet për mosdhënien e

informacionit para intervistës, përpos një pretendimi të përgjithësuar meqenëse korniza ligjore në fuqi nuk e diktonte nevojën për një gjë të tillë.

- 2.18. Gjatë intervistës, në mënyrë përsëritëse dhe jo të saktë Prokurori i tha parashtruesit se refuzimi i tij për t'iu përgjigjur pyetjeve bazohej në të drejtën e tij kundër vetinkriminimit. Është me rëndësi të theksohet se kjo gjykatë është e vetëdijshme se e drejta kundër vetinkriminimit dhe e drejta për të mbajtur heshtje janë të veçuara prej njëra-tjetrës, garantimi i të cilave i kërkohet gjykatës prej Kushtetutës, rregullave të veta dhe instrumenteve ndërkombëtare përkatëse.

3. Korniza ligjore

- 3.1. Autoriteti ligjor i Dhomave të Specializuara të Kosovës (më tej: Dhomat) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar përcaktohet në *Ligjin nr.05/L-053*.
- 3.2. Duke marrë parasysh natyrën e Dhomave, që janë një institucion vendor por që kanë në përbërje vetëm gjykatës ndërkombëtarë, ndonëse ligji për Dhomat është i veçantë dhe i dallueshëm, leximi i tij duhet të bëhet njëkohësisht me leximin e Kushtetutës së Kosovës dhe të pjesëve përkatëse të Kodit Penal të Kosovës.
- 3.3. Të drejtat e të akuzuarit gjenden në *nenin 21* të Ligjit, ku i referohemi veçanërisht *nenit 21(4)(a)* në të cilin lexohet:
4. *Në përcaktimin e akuzave kundër të akuzuarit sipas këtij ligji, i akuzuari gëzon të drejtën e garancive minimale të mëposhtme, me barazi të plotë, që:*
- a. *të njoftohet me kohë dhe në hollësi në gjuhën që ai e kupton për natyrën dhe shkaqet e akuzës kundër tij.*

- 3.4. *Neni 38 i Ligjit përcakton procedurën 'Hetimet dhe përgatitja e aktakuzës'.*
- 3.5. Sa i përket 'hetimit', *neni 38(3)(a)* ka rëndësi të konsiderueshme kur përcakton si vijon:
3. *Nëse merret në pyetje, i dyshuari nuk detyrohet të fajësojë veten apo të pranojë fajësinë. I dyshuari nuk i nënshtrohet asnjë forme të shtrëngimit, trysnisë apo kërcënimit, torturës, apo asnjë forme tjetër të trajtimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor dhe degradues. Ai ose ajo ka këto të drejta, për të cilat ai informohet para marrjes në pyetje, në gjuhën që ai e flet dhe e kupton:*
- a. *të drejtën për t'u informuar se ekzistojnë arsye për të besuar se ai ka kryer ndonjë krim brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.*
- 3.6. Në lidhje me 'Rregulloren e Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës', i referohemi *rregullës 43 – Të drejtat e të dyshuarve gjatë hetimit*, ku në paragrafin (1) lexohet:
- (1) *Në qoftë se Prokurori i Specializuar ka arsye për të dyshuar se një person ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, personi në fjalë konsiderohet i dyshuar dhe pasi informohet për këtë, gëzon të paktën të drejtat e përcaktuara në nenin 38(3) të Ligjit.*
- 3.7. Ankesa e parashtruesit përqendrohet së pari në kuptimin e termit 'akuzë', dhe së dyti nëse të drejtat e përcaktuara në *nenin 21(4)*, janë të zbatueshme gjatë procesit hetimor dhe rrjedhimisht nëse përfshihen në *nenin 38*.
- 3.8. Gjithashtu dhe/ose në alternativë, shqyrtohet edhe nëse e drejta e përcaktuar në *nenin 38* përfshin edhe dhënien e detajeve të veprës penale që dyshohet se është kryer dhe bazën mbi të cilën mbështetet dyshimi se parashtruesi ka kryer veprën penale në fjalë.

3.9. Me respekt Dhomës i sillet në vëmendje *neni 19* i Ligjit, në veçanti paragrafi (2), ku lexohet:

2. *Rregullat e procedurës dhe provave pasqyrojnë standardet më të larta të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe Marrëveshjen Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (MNDCP), me synim garantimin e shqyrtimit gjyqësor të drejtë dhe të shpejtë..."*

4. Parashtrimet

4.1. Argumentet e parashtruesit janë të dyfishta.

4.2. Së pari, me respekt parashtrohet se qasja e përcaktuar prej Ligjit në nenin 21(4)(a), për atë që ka të bëjë me bërjen të ditur të bazës së akuzës, duhet lexuar brenda kontekstit të nenit 38(3)(a), dhe për këtë arsye, ekziston një kusht që individët të cilët thirren për marrje në pyetje si të dyshuar, duhet të informohen për natyrën konkrete të veprës penale në lidhje me të cilën merren në pyetje dhe gjithashtu për provat ku bazohet pretendimi.

4.3. Si pasojë, mosdhënia e informacionit me shkrim, qoftë para datës së marrjes në pyetje, apo menjëherë para marrjes në pyetje të parashtruesit, ishte e paligjshme dhe rrjedhimisht intervista e parashtruesit nuk është e pranueshme në procedura në rast se do të paraqitet aktakuzë.

4.4. Së dyti, dhe/ose në alternativë, në qoftë se neni 38 nuk do të lexohet së bashku me nenin 21, ose neni 21 nuk do të lexohet brenda kontekstit të nenit 38, duke u bazuar në kufizimet e nenit 38, neni 38 në formën që është hartuar dhe miratuar e si rrjedhojë edhe rregulla 43(1), janë jokushtetuese, duke marrë parasysh nenin 19 të Ligjit.

4.5. Më tej, në lidhje me nenin 19 të Ligjit, i referohemi nenit 2 si vijon:

“Çdo kufizim i të drejtave dhe lirive themelore bëhet në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës për qëllime objektive dhe të arsyeshme që janë shprehur në këtë nen, në pajtim me kapitullin II të Kushtetutës dhe standardet ndërkombëtare të drejtësisë dhe procesit të drejtë. Këto qëllime janë në interesin e Kosovës si shoqëri e hapur dhe demokratike dhe janë në shërbim të përmbushjes së obligimeve ndërkombëtare të Kosovës. Në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës, këto kufizime shqiptohen vetëm në masën e nevojshme për përmbushjen e këtyre qëllimeve jetike”.

4.6. Në përcaktimin se çfarë të drejtash ka ‘i dyshuari’ gjatë marrjes në pyetje, si udhëzues shërbejnë ligjet për të drejtat e njeriut që janë të detyrueshme për Kosovën dhe për të cilat edhe Dhomat pranojnë se janë të detyrueshme për to, sikurse përmenden në nenin 2.

4.7. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, në bazë të një parimi themelor mbrojtësi i autorizuar, *duhet* të jetë në gjendje të përfaqësojë në mënyrë adekuate individin që merret në pyetje dhe këtu përfshihet edhe aftësia për të ofruar këshilla në lidhje me sa vijon:

- a) nëse fletëthirrja është e ligjshme;
- b) nëse individi duhet t’u përgjigjet pyetjeve; ose
- c) nëse individi duhet të ushtrojë të drejtën për të mbajtur heshtje.

4.8. Ky parim është pranuar në shumë institucione vendore si edhe në mekanizma ndërkombëtarë.

4.9. I referohemi Direktivës së BE-së 2012/13/EU, të 22 majit 2012, ku në paragrafin 28 lexohet:

Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese
në lidhje me Ligjshmërinë e Procedurës së Marrjes në Pyetje
Driton Lajçi

“Të dyshuarve ose të akuzuarve u jepet pa vonesë informacion në lidhje me veprën penale për kryerjen e së cilës ata dyshohen ose akuzohen, më së voni para intervistës së tyre të parë zyrtare me policinë apo një instancë tjetër kompetente dhe pa paragjykuar rrjedhën e hetimeve në kryerje e sipër. Përshkrimi i fakteve, ndër të cilat përfshihen, nëse janë të ditura, koha dhe vendi që kanë lidhje me veprën penale për kryerjen e së cilës dyshohen ose akuzohen personat në fjalë dhe cilësimi i mundshëm ligjor duhet të jepen me detaje të mjaftueshme, duke marrë parasysh fazën e procedurës penale kur jepet përshkrimi, për të garantuar drejtësinë e procesit dhe mundësuar ushtrim të efektshëm të të drejtave të të dyshuarve ose të akuzuarve”.¹

- 4.10. Sikurse është aluduar tashmë, ‘Ligji’ dhe ‘Rregullorja’ e Dhomave përmendin dhënien e informacionit dhe të drejtën e një individi për t’u informuar në lidhje me thelbin e akuzës kundër tij ose saj.
- 4.11. Aspekti se kur konsiderohet që një individ është ‘akuzuar’, ose çfarë përbën ‘akuzë’, është trajtuar prej Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut.
- 4.12. Në *Ibrahim and others v. The UK*,² Dhoma e Madhe, duke filluar prej paragrafit 203 e më tej shqyrton Direktivën e lartpërmendur të BE-së dhe thekson se vetëm Britania e Madhe, Irlanda dhe Danimarka vendosën të mos merrnin pjesë. Pranohet se Kosova nuk është anëtare e BE-së; sidoqoftë duke u nisur nga fakti se Kosova kërkon anëtarësimin në BE dhe gjithashtu se vetë Dhomat kanë konfirmuar se ligjet përkatëse për të drejtat e njeriut janë të detyrueshme për to, me respekt parashtrohet se Direktiva është relevante për procedurat e përdorura prej ZPS-së.

¹ <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2012:142:0001:0010:en:PDF>

² [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-166680"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

- 4.13. Për më tepër dhe gjithsesi duke mbajtur parasysh rastin *Ibrahim*, në paragrafin 249, Dhoma e Madhe shqyrton çfarë përbën ‘akuzë penale’, dhe përcakton:

“Garancitë që ofron neni 6(1) dhe (3) i Konventës janë të zbatueshme për një person që është objekt i një “akuze penale”, brenda kuptimit autonom të këtij termi në Konventë. Një “akuzë penale” ekziston prej momentit kur një individ informohet zyrtarisht prej autoritetit kompetent se ekziston pretendim që ai ka kryer një veprë penale, ose që prej pikës në të cilën situata është ndikuar thelbësisht nga veprimet e ndërmarra nga autoritetet si rezultat i një dyshimi kundër tij”³

- 4.14. Gjithashtu rasti *Ibrahim* dhe përkufizimi i termit ‘akuzë penale’ u përmendën nga Dhomat në *“Shqiptim i Vendimit mbi Referimin e z. Mahir Hasani në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë të 20 dhjetorit 2018.”*⁴

- 4.15. Në atë rast, Dhoma konstatoi:

*“Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konfirmuar se garancitë që ofron neni 6(1) dhe (3) i Konventës janë të zbatueshme për një person që është objekt i një “akuze penale”... Dhoma e Madhe e Gjykatës së Strasburgut miratoi qasjen e përdorur në *Aleksandr Zaichenko v. Russia*, ku Gjykata kishte shpjeguar se nëse ekziston dyshimi që një person ka kryer veprë penale, ai person konsiderohet se është objekt i një ‘akuze’ në kuptimin e nenit 6 të Konventës.”*

- 4.16. Neni 6(3)(a) i Konventës vë në dukje se vëmendje e posaçme i duhet kushtuar informimit të të pandehurit për çfarëdo “akuzash”, meqenëse detajet e veprës

³ Gjithashtu shih *Deweere v. Belgje*, 27 February 1980, *Eckle v. Germany* 15 July 1982, and *McFarlane v. Ireland* [GC] 10 September 2010.

⁴ KSC-CC-2019-05 - <https://www.scp-ks.org/en/documents/pronouncement-ruling-referral-mr-mahir-hasani-concerning-prosecution-order-20-december>

penale janë kyçe për t'i mundësuar një individ që të përgatisë mbrojtjen e vet e më tej që të marrë pjesë aktive në mbrojtje.⁵

- 4.17. Sidoqoftë, e drejta e nenit 6(3) zhvillohet edhe në kuptimin se i jep të pandehurit të drejtën që të informohet jo vetëm për “shkakun” e akuzës, d.m.th, për veprimet që ai ose ajo dyshohet se ka kryer, por edhe për natyrën e akuzave, duke iu referuar *Mattoccia v. Italy*.⁶
- 4.18. Rrjedhimisht, duket se është e qartë se kur parashtruesi mori fletëthirrjen ku informohej se ai dyshohej për kryerjen e një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, në atë moment ai ‘ ishte objekt i një akuze penale’.
- 4.19. Si pasojë, me respekt parashtrohet se garancitë që i ofrohen një individ i cili është objekt i një akuze penale sipas nenit 38(3)(a) zbatohen në kuptimin se parashtruesi kishte të drejtë të informohej për veprën/veprat penale konkrete për kryerjen e së cilës/të cilave dyshohej, dhe se ku bazohej dyshimi.
- 4.20. Para intervistës, parashtruesi bëri kërkesë përmes përfaqësuesve të vet ligjorë të emëruar, në lidhje me bazën dhe arsyet e pretendimeve, gjegjësisht cilat ishin pretendimet konkrete. U theksua se fletëthirrja nuk ishte e detajuar në mënyrë të mjaftueshme dhe nuk bënte të ditur ndonjë veprë penale në shkelje të standardeve të pranuar ndërkombëtare për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale. Gjithashtu në kërkesë theksohej se nuk ishte bërë i ditur asnjë material që mund të përbënte bazën dhe arsyet e ndonjë pretendimi. Kjo kërkesë u përsërit si në fillim të intervistës, po ashtu dhe gjatë kryerjes së intervistës. Në emër të parashtruesit, ZPS-së iu ofrua mundësia që të

⁵ Shih *Pelissier and Sassi v. France* [GC] [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-58226"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{); dhe *Kamasinski v. Austria* [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-57614"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

⁶ [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-58764"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{); shih edhe *Penev v. Bulgaria* <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-96610>

ndërpriste intervistën dhe të caktonte një datë të re, për t'i mundësuar përmbushjen e obligimeve sipas kornizës ligjore në fuqi. ZPS-ja e refuzoi këtë.

4.21. ZPS-ja vazhdoi me intervistën e vet dhe përsëri nuk ia specifikoi pretendimet parashtruesit, pavarësisht se ai vendosi të ushtronte të drejtën e heshtjes.

4.22. Për këto arsye, mospërmbushja e obligimeve të lartpërmendura prej ZPS-së është jokushtetuese dhe si pasojë:

- a) Intervista duhet të konsiderohet e paligjshme;
- b) Intervista duhet të konsiderohet e papranueshme;
- c) Procedura e përdorur prej ZPS-së përgjithësisht është jokushtetuese; dhe
- d) Duke mbajtur parasysh pikën (c), duhen ndërmarrë masa për hartimin e një udhëzuesi pune të përshtatshëm për të mundësuar që çdo intervistë të kryhet në pajtim me ligjin.

5. Përfundim

5.1. Mendimi i parashtruesit është se procedurat e përdorura prej ZPS-së për fletëthirrjet dhe marrjet në pyetje të individëve së pari nuk janë në pajtim me autoritetin ligjor të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Rregulloren e Procedurës dhe të Provave të tyre; në qoftë se do të vendoset se procedurat janë në pajtim me atë autoritet dhe me rregulloren, atëherë argumenti alternativ është se autoriteti dhe rregullorja nuk janë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ku përfshihet Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për pasojë janë jokushtetuese.

- 5.2. Në Statutin themelues të tyre, Dhomat e Specializuara të Kosovës pranojnë se janë nën detyrimin e të drejtës përkatëse ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ku përfshihet edhe Konventa Evropiane, rrjedhimisht duhet të respektohen të drejtat e parashtruesit sipas nenit 6 të Konventës.
- 5.3. Të drejtat e parashtruesit sipas nenit 6 përfshijnë edhe ato të paragrafit 3 të nenit 6 e për rrjedhojë përfshijnë të drejtën për t'u informuar konkretisht për veprën penale të cilën ai dyshohet të ketë kryer, e gjithashtu edhe për bazën ku mbështetet dyshimi.
- 5.4. Mospërmbushja e këtyre detyrimeve nuk i mundësoi parashtruesit të merrte këshilla tërësore prej mbrojtësit të autorizuar e rrjedhimisht është penguar pjesëmarrja e tij aktive në mbrojtjen e vet, dhe si rezultat procedurat e përdorura përbëjnë shkelje të qartë të nenit 6.
- 5.5. Rrjedhimisht, rrethanat të cilat janë objekt i ankesës së parashtruesit, shkelin të drejtat dhe liritë individuale të garantuara prej Kushtetutës.

/nënshkrim/

Tobi Kadman

Numri i fjalëve [në anglishte]: 3292

Emri i gjykatësit/pjesëmarrësit

Titulli i gjykatësit/pjesëmarrësit

13 nëntor 2019

Në Hagë, Holandë